



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	15.04.2024
REFERENC-Ë:	319/22 - ARPL
PËR/ZA/TO:	„ALTRADE BETON “ SH.P.K., Miradi e Epërme, Fushë Kosovë.
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së Naser HAFIZI- Zëvendësues i Udhëheqësit të ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Sylejmon Latifi - Zyrtar përgjegjës për akte ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim – Leje Ujore, Shfrytëzim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me Nr. të protokollit: 319/22, dt.24.01.2022, për shfrytëzim të ujit nga puset, Betonierka „ ALTRADE BETON “ SH.P.K., Miradi e Epërme- Fushë Kosovë dhe ka vendosur si në Vendimin për Leje Ujore, pas plotësimit të dokumentacionit për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkresë përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

Datë: 15.04.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitive ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës "ALTRADE BETON" SH.P.K., Miraçi e Epërme-Fushë Kosovë, me Nr. prot. 319/22, dt.24.01.2022 për **LEJE UJORE**, për shfrytëzimin e ujit nga pusët për Betonierkën, sipas kushteve vijuese:

1. Uji për shfrytëzim do të jetë, pusi-P1 $Q_{max} = 2.5$ l/s (dy pikë pesë litra për sekond), sipas kërkesës së projektit të dorëzuar, në pikën me koordinata $X=7506991$ dhe $Y=4719685$;
2. Uji për shfrytëzim do të jetë, $Q_{max} = 6$ l/s (gjashtë litra për sekond), sipas kërkesës së projektit të dorëzuar, në pikën me koordinata $X=7507038$ dhe $Y=4710690.8$;
3. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m^3 /ditë), dhe sasinë vjetore (m^3 /vit).

Për sasi të shfrytëzuara pala obligohet që për çdo gjashtë muaj të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;

4. Nr. Serik i ujëmatësit për pusin, duhet prezantuar në ARPL/MMPHI, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij vendimi, si dhe për ndërrimin e mundshëm të tij, duhet informuar Organi përgjegjës, që e ka lëshuar këtë vendim;
5. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas UA në fuqi për Strukturën e pagesave të ujit;
6. Për këtë pala obligohet të raportoj për perioda kohore të shfrytëzimit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
7. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
8. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
9. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
10. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër;

Arsyetim

Zyrtari përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: "Elaborati dhe dokumentacioni tekniko- investiv për shfrytëzimin e ujit nga Betonierka "ALTRADE BETON" SH.P.K, Miradi e Epërme- Fushë Kosovë"; marrëveshje bashkëpunimi me "F & K" SH.P.K, për kompletimin e dokumentacionit; Diploma e Qëndresa Hamdi Kadrijaj, Master i Shkencave Teknike të Ndërtimtarisë; Diploma e Shkelzim Sinan Tahiraj, Bachelor i Ndërtimtarisë; Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit - ARBK - "AL TRADE BETON" SH.P.K; Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit të kompanisë hartuese - ARBK - " F&K " Sh.p.k; Pëlqim Mjedisor për bazën e prodhimit të betonit " As Partners" Sh.p.k me nr.19/1236/2-ZSP/251/19, të datës 14.05.2019; Leje

Mjedisore për bazën e prodhimit të betonit " As Partners" Sh.p.k me nr.19/6158/ZSP/20, të datës 27.08.2020; Kopja e lejes mjedisore me nr.19/6158/ZSP/20, të datës 27.08.2020 e transferuar nga "AS PARTNERS" Sh.p.k te operatori "AL TRADE BETON" Sh.p.k; Kontratë mbi qiranë me akt noterial mes Qiradhënësit "AS PARTNERS" dhe Qiramarrësit "AL TRADE BETON"; Leje nga 710/KPMM/2019 "AS PARTNERS" Sh.p.k, Çertifikatë e pronësisë; Kopja e Planit; Koordinatat; Plani i Situacionit i punuar nga person i licencuar i lëmise përkatëse, me nr. licencë 181, Agon Elshani; Situacioni i terrenit 1:1000; CD.

Faturat e pagesave për Kushte Ujore , Pëlqim Ujor dhe Leje Ujore.

Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, informatave shtesë me Nr. prot. 319-2/22, dt.26.01.23, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 319/22- ZSP- 2024 Datë: 15.04.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Fushë Kosovë;
- Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së



Faqe 4 nga 4